



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde

18 korrik 2019

## **Komente në Draft - Rregulloren për Emërimin e Kryeprokurorëve të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës**

### **1. Hyrje**

Instituti i Kosovës për Drejtësi (*Tutje*: IKD) pas analizimit të Draft Rregullore për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës (*Tutje*: Rregullorja), paraqet komentet e më poshtme lidhur me draft rregulloren.

### **2. Kriteret e përgjithshme (Neni 3)**

Ky nen përcakton se “Aplikuesit e interesuar për të aplikuar për pozitën e KPSH dhe kryeprokurorit të prokurorive përkatëse duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme, si në vijim:

- 1: Të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
- 2: Të mos ketë të ngritur aktakuzë
- 3: Të mos jetë i dënuar, me përjashtim të kundërvajtjes;
- 4: Të ketë vlerësim pozitiv të performancës në tri vitet e fundit
- 5: Të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore në pesë vitet e fundit;
- 6: Të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet moral”.

Fillimisht, kriteret lidhur me emërimin e Kryeprokurorëve duhet të jenë në harmoni të plotë me kriteret e përcaktuara në ligjet bazike si Ligji për PSH dhe Ligji për PSRK. Kjo për arsye se kriteret për tu përzgjedhur në pozita të tilla përcaktohen me ligj, dhe jo me akte nënligjore sikurse në këtë rast. Rregullorja e KPK-së në rastin konkret do të duhej që vetëm të përcaktonte procedurën e brendshme për të zgjedhur kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj. Për më tepër, në asnjë rrethanë rregullorja nuk mund ti krijojë dualizëm

dhe as nuk mund të barazohet me ligjin. Përpos në këtë rast, kjo logjikë është e shprehur edhe në nenin 16.3 ku janë përcaktuar arsyet që duhet ti përmbajë kundërshtimi. Në këtë paragraf është përcaktuar se kundërshtimi duhet të përmbajë arsyet për moszbatim të ligjit apo të kësaj rregulloreje. Për këtë arsye, KPK duhet ta ketë të kuartë natyrën juridike të legjislacionit sekondar, në rastin konkret të rregullores.

Tutje, KPK ka përcaktuar kritere që aplikon standarde të dyfishta. Në njërën anë, KPK ka përcaktuar si kriter që kandidati të mos ketë të ngritur aktakuzë. Ky formulim ndikon që kandidati të mund të aplikojë për pozitën e kryeprokurorit të një prokurorie, edhe nëse ndaj të njëjtit janë duke u zhvilluar hetime, respektivisht në përmes kësaj dispozite një kandidat mund të kandidojë nëse ndaj tij është nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve, që sipas Kodit të Procedurës Penale prodhon edhe pasoja juridike. Në anën tjetër, në paragrafin 5 është përcaktuar si kriter që kandidati që aplikon të mos ketë masë disiplinore në pesë vitet e fundit. Në aspektin e pasojës juridike, aktvendimi për fillimin e hetimeve është masë shumë më e rëndë se sa shqiptimi i një mase të lehtë disiplinore, me përjashtim të shqiptimit të masave të rënda disiplinore.

Kufizimi i përcaktuar në paragrafin pesë të këtij neni, që kandidati për kryeprokurorë duhet që të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore në 5 vitet e fundit është në kundërshtim me frymën dhe qëllimin e LPDGJP . KPK me këtë nen nuk përcakton fare se për çfarë masash disiplinore bëhet fjalë. Sipas nenit 7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve kemi 5 lloje të sanksioneve disiplinore. Ndër to është edhe vërejtja jopublike me shkrim. Sipas paragrafit 4 të këtij neni, vendimi për këtë sanksion penal nuk publikohet fare në faqen zyrtare të KPK-së. Ndërsa, sipas kësaj rregulloreje, kjo masë është pengesë për një prokurorë që i njëjti të zgjidhet/propozohet për kryeprokurorë. Për këtë arsye, KPK duhet ti shmanget gjuhës së tillë të përdorur në këtë rregullore e cila përjashton pa bazë ligjore prokurorët për të aplikuar për pozitën e kryeprokurorit, dhe të përcaktojë se cilat sanksione disiplinore janë pengesë.

KPK nuk mund të ndërtoj praktikë që potencialisht një kandidat për Kryeprokuror t'i mundësohet të kandidoj me aktvendim për fillim të hetimeve dhe në anën tjetër t'i kufizohet një kandidati tjetër që ka masë disiplinore si psh vërejtja jo-publike me shkrim.

Po ashtu, në këtë nen duhet të rregullohet gjuha e përdorur dhe të harmonizohet me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorë, në atë mënyrë që të thuhet “sanksionet disiplinore” dhe jo “masat disiplinore”.

### 3. Kriteret e veçanta (Neni 4)

Përderisa për të gjitha prokuroritë janë përcaktuar kriteret e veçanta për kryeprokurorë, kjo nuk është bërë për Kryeprokurorin e PSRK-së, ku është përcaktuar se “për emërim në pozitën e kryeprokurorit të PSRK-së, kandidati duhet ti plotësoj kriteret e parapara me ligj”. Këtu fillimisht janë 2 probleme. E para është se ka përdorim të standardeve të dyfishta përballë prokurorive të tjera, ku për të tjerat janë përcaktuar strikt kriteret e veçanta ndërsa në këtë rast është përcaktuar si e përgjithshme. Duhet ta kemi parasysh se kriteret përcaktohet me ligj për të gjitha prokuroritë dhe jo vetëm për PSRK, andaj duhet edhe të përdoren standarde të njëjta. E dyta është se secilin kandidat potencial për këtë pozitë, KPK e vendos para një pasigurie juridike. Për këtë arsye, dispozita duhet të jetë precize dhe me kuptim të ngushtë. **Andaj, kjo dispozitë duhet të riformulohet në këtë mënyrë “Për të ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, prokurori duhet t'i plotësojë kushtet për të punuar si prokurorë në Departamentin për Krime të Rënda, si dhe të ketë vlerësimin pozitiv të performancës.** Periudha e ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë Speciale, të caktuar sipas dispozitave të këtij Ligji, llogaritet si përvojë e prokurorit në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore.”

### 4. Konfirmimi i statusit të kandidatit (Neni 7)

Në fund të paragrafit 5 të jetë “...që dëshmojnë se aplikuesi i plotëson kriteret për kandidat” dhe jo “...që demonstron se aplikuesi i plotëson kriteret për pozitën”.

### 5. Përjashtimi i anëtarëve të KPK-së (Neni 8)

Sipas këtij neni, “Cilido anëtar i KPK që ka konflikt interesi ose **sinqerisht** beson se nuk mund të merr vendim të drejtë në vlerësimin e cilitdo kandidat do të tërhiqet nga pjesëmarrja në proces për të gjithë kandidatët”.

Duhet të kemi parasysh se ky përkufizim i konfliktit të interesit nuk gjendet në asnjë prej ligjeve bazike. **Pjesa “sinqerisht beson”**, është plotësisht e pakuptueshme dhe e paarsyeshme. Për këtë arsye, duke pre supozuar se KPK është e njoftuar mbi natyrën juridike të legjislacionit sekondar, në këtë rregullore duhet të përfshihet definicioni primar i cili gjendet në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Sipas nenit 6 të këtij ligji “Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”. Andaj, formulimi i kësaj dispozite duhet të jetë: “Cilido anëtar i KPK-së që ka konflikt interesi do të tërhiqet nga pjesëmarrja në proces për të gjithë kandidatët”.

## **6. Sjellja gjatë procesit (Neni 9)**

Paragrafi 2 i këtij neni përcakton se “Asnjë aplikues, kandidat apo anëtar i KPK nuk do të tentojë të ndikojë në anëtarët tjerë të KPK rreth procesit të përzgjedhjes. Kushdo që gjendet në shkelje të kësaj rregulle do t’i nënshtrohet masave dëgjimore”.

Në këtë paragrafi përpos aplikuesit, kandidatit dhe anëtarëve të KPK-së duhet të futet edhe secili akter tjetër i sistemit prokurorial (kryeprokurorë, prokurorë etj.), në mënyrë që tu pamundësohet edhe atyre që në çfarëdo formë të ndikojnë në këtë proces.

Po ashtu ky nen në mënyrë të qartë duhet të përcaktojë se qasja apo përpjekja për të ndikuar tek anëtarët e KPK-së me automatizëm dërgon në përjashtimin nga gara e kandidatit.

## **7. Paneli Vlerësues dhe procedura e intervistimit (Neni 11)**

Pas përfundimit të paragrafit 2 të këtij neni, të shtohen edhe fjalët “vënia e emrave dhe tërheqja e shortit bëhen gjatë takimit të KPK-së”. Kjo për arsye që të qartësohet se kjo procedurë duhet të ndiqet gjatë takimit të KPK-së, i cili në bazë të nenit 14.1 të Ligjit për KPN-në është publik. Në këtë mënyrë si është formuluar, nuk krijohet përshtypja se kështu është përcaktuar. Po ashtu, kështu duhet të vepohet edhe në paragrafin 9 të këtij neni si dhe në paragrafin 4 të nenit 12, i cili flet për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për Rishqyrtim.

Po ashtu, sa i përket këtij neni, tek paragrafi 6, duhet të përcaktohet saktë se sa kohë para intervistës përpilohen pyetjet nga ana e kryesuesit dhe anëtarëve të panelit vlerësues.

## **Neni 13 Kriteret për poentim**

1. Poentimi i kandidatëve do të bazohet në kriteret e përgjithshme si në vijim:

1.1 Koncepti dokumenti dhe prezantimi i tij - deri në 30 pikë;

1.2 Integriteti i kandidatit - deri në 20 pikë;

1.3 Aftësitë Udhëheqëse dhe Menaxheriale - deri në 30 pikë;

1.4 Njohuritë teknike dhe përvoja e nevojshme për ushtrim të funksionit deri në 20 pikë.

Kryeprokurori i Shtetit dhe Kryeprokurorët e Prokurorive përkatëse varen se si interpretohet dhe zbatohet në praktikë ky nen.

KPK duhet të përcaktojë qartë procedurën për përzgjedhjen dhe emërimin, duke përfshirë sigurimin e rregullave dhe kriterëve të qarta, transparente dhe objektive, të udhëhequr në kompetencë, integritetit dhe pavarësi.

Ky nen i ve në pozitë të pabarabartë numër të caktuar të kandidatëve që nuk kanë qenë Kryeprokuror apo që nuk kanë pasur pozita menaxheriale. Paragrafi 1.3 është vendimtar për të paragjykuar kryeprokurorin e një prokurorie të caktuar në rastet kur kandidatë kemi një kryeprokuror në raport me një prokuror. Në këtë drejtim, paragrafi 1.3 duhet të sqarohet më tepër, në mënyrë që kandidatët që aplikojnë për këtë pozitë ta kenë të qartë se cka

nënkuptohet me aftësi udhëheqëse dhe menaxheriale, a nën-kupton përvojën e punës apo aftësitë për të udhëhequr dhe menaxhuar me prokurorinë përkatëse.

Për më tepër pyetjet në koncept dokument për Kryeprokuror të Shtetit janë në kundërshtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që sipas ligjit i ka një Kryeprokuror i prokurorisë përkatëse.

Në këtë drejtim kriteret në këtë nen janë në kundërshtim të plotë me mënyrën se si është hartuar forma e koncept dokumentit, e cila ka 30 pikë, dhe që në bazë të përgjigjeve të dhëna nga kandidatët mund të ndikojë edhe në poentimin tek aftësitë udhëheqëse dhe menaxheriale që poentohet deri në 30 pikë.

Pyetjet e më poshtme janë shumë të paqarta, konfuze dhe që dalin jashtë fushëveprimit të pozitave për Kryeprokuror të Apelit, Speciales apo Prokurorive Themelore.

### **I. Analiza juaj për gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit;**

**Koment:** *Përgjigjet në këto pyetje mund të kenë kundër efekt, dhe më shumë ngjasojnë pyetje profesor-student se sa pyetje për të pasur të qarte vizionin e Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse lidhur me menaxhimin dhe administrimin .*

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?
2. Cilat mendoni se janë përparësitë kryesore të Prokurorisë së Shtetit ?
3. Cilat janë mangësitë kryesore të Prokurorit të Shtetit?
4. Cilat janë rreziqet, sfidat dhe/apo mundësitë e veçanta?

### **III. Vizioni juaj ne përmirësimin e punës operative ne Prokurorinë e Shtetit?**

**Koment:** *Këto pyetje janë më shumë për Pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit se sa për Kryeprokurorët e prokurorive tjera.*

Ju lutem listoni/përmendni veprimet e juaj afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjate:

1. Cili është vizioni juaj për Prokurorinë e Shtetit gjatë mandatit tuaj?
2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?
3. Cilat vështirësit apo rreziqet që i prisni gjatë përmbushjes së këtyre objektiveve?
4. Si do t'i tejkaloni ato?

### **IV. Vizioni për te menaxhuar me personelin ne sistemin prokurorial;**

Ju lutem renditni hapat konkret që do t'i ndërmerrni gjatë mandatit tuaj?

**Koment:** *Këto pyetje kanë qenë të aplikueshme për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit në vitin 2014 dhe 2015, kur i njëjti ka ushtruar pozitën e Kryesuesit të KPK-së dhe atë të Kryeprokurorit të Shtetit. Këto kompetenca janë të KPK-së dhe jo të kryeprokurorëve. Zhvillimi në karrierë i prokurorëve rregullohet me ligj dhe politika të KPK-së dhe përmes komisioneve të KPK-së, dhe nuk është aspak kompetencë e KPSH apo Kryeprokurorëve.*

*E njëjta vlen për stafin mbështetës, ku zbatohet ligji për Shërbimin Civil ku kryeprokurorët*

*nuk kanë asnjë kompetencë.*

Llogaridhënia dhe profesionalizimi është kompetencë e KPK-së, dhe assesit e KPSH-së apo Kryeprokurorëve.

1. Cilat është stili juaj menaxhues në menaxhimin e stafit?
2. Si planifikoni të ndërtoni sistem të zhvillimit në karrierë për stafin?
3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?

#### **V. Hapat për tu ndërmarrë në përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënies së sistemit dhe besimin e publikut?**

**Koment:** *Edhe te këto pyetje ka përzierje të kompetencave dhe përgjegjësive mes KPK dhe Kryeprokurorëve.*

Ju lutem listoni/përmendni veprimet e juaj afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjate:

1. Përvoja e juaj e deri tanishme?
2. Hapat që do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë së sistemit prokurorial duke vene barazpeshe mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?
3. Çfarë planifikoni të ndërmerrni për të siguruar pune kualitative të prokuroreve?
4. Çfarë planifikoni të përmirësoni në llogaridhënien e përgjithshme të sistemit?

#### **8. Procesi i poentimit (Neni 14)**

Lidhur me procesin e kalkulimit të rezultatit nga Sekretariati i KPK-së, paragrafi 6 i këtij neni përcakton se ky proces bëhet nën mbikëqyrjen e Kryesuesit të Panelit Vlerësues, i cili realisht është kryesuesi i KPK-së. Fillimisht, duhet vëmë theksin se ky proces nuk është i parëndësishëm, andaj me parëndësinë e të njëjtit nuk mund ta arsyetojmë mos pjesëmarrjen e anëtarëve të tjerë të Panelit Vlerësues në këtë panel. Për këtë arsye, në paragrafin 6 duhet të përcaktohet se përpos kryesuesit të panelit vlerësues, këto veprime duhet të kryhen edhe nën mbikëqyrjen e anëtarëve të tjerë të Panelit Vlerësues.

Pas paragrafi të 6, për shkak të sigurisë juridike dhe transparencës, duhet të përcaktohet edhe obligimi i sekretariatit të KPK-së që përkitazi me kalkulimin e bërë, të përpilojë një raport të arsyetuar, i cili duhet të jetë pjesë e dosjes së secilit kandidat.

#### **9. Njoftimi i kandidatëve (Neni 15)**

Në paragrafin 2 të këtij neni, të shtohet edhe nën paragrafi 2.3 që përcakton se kandidatit i dërgohet edhe raporti i kalkulimit të rezultatit. Kjo për arsye se për çfarëdo gabimi në këtë kalkulimin e bërë, kandidatit i ipet mundësia që ndaj këtij kalkulimi të bëjë kundërshtim sipas nenit 16 të kësaj rregulloreje.

## 10. Kundërshtimi i kandidatëve ndaj procesit të poentimit (Neni 16)

Për të shqyrtuar kundërshtimet ndaj procesit të poentimit, kjo rregullore ka përcaktuar Komisionin për Rishqyrtim në nenin 12, ndërsa ka përcaktuar edhe kompetencat e këtij komisioni dhe procedurën e kundërshtimeve në nenin 16 të kësaj rregulloreje.

Por, për kah kompetencat e këtij komisioni dhe shkallshmërisë në shqyrtimin e kundërshtimeve, kjo rregullore përcakton një sistem të çoroditur, i cili nuk gjendet askund. Më konkretisht, në njërin rast Komisioni për Rishqyrtim është organ i shkallës së dytë dhe përfundimtar për të vendosur mbi kundërshtimet e paraqitura ndërsa në rastin tjetër është organi i shkallës së dytë, nga 3 shkallë të përcaktuara në këtë rregullore. Në rastin e dytë, si shkallë e tretë është KPK.

Sipas paragrafit 5 të nenit 16 të rregullores, “Komisioni për Rishqyrtim shqyrton kundërshtimet për të përcaktuar nëse janë të bazuara. Komisioni për rishqyrtim voton për kundërshtimin”. Ndërsa, sipas paragrafit 6 të këtij neni, “Nëse Komisioni për Rishqyrtim vlerëson se kundërshtimi është i bazuar, i dërgon KPK-së raport të arsyetuar”. Sa i përket këtij raporti, Rregullorja përcakton se “KPK voton mbi propozimin e Komisionit për Rishqyrtim” dhe se “Nëse KPK aprovon të gjeturat e Komisionit për Rishqyrtim sipas paragrafit 6, KPK kërkon nga anëtarët e Panelit Vlerësues që të rishikojnë edhe njëherë procesin për të adresuar të gjeturat”. Pra, mbi vlerësimin e Komisionit për Rishqyrtim, si vlerësim përfundimtar do të jetë vendimi i KPK-së.

Por, kjo nuk është kështu në rastet kur Komisioni për Rishqyrtim konstaton se kundërshtimi është i pabazuar. Në këtë rast, sipas kësaj rregulloreje, konfirmohet poentimi përfundimtar, dhe të njëjtin vlerësim të Komisionit për Rishqyrtim nuk e rivlerëson KPK. Lidhur me këtë, paragrafi 9 i nenit 16 të rregullores përcakton se “Nëse KPK refuzon të gjeturat e Komisionit për Rishqyrtim sipas paragrafit 6, poentimi final do të konfirmohet dhe KPK kalon në procesin e votimit”.

IKD vlerëson se kjo mënyrë e përcaktimit të procedurës ku përcaktohet se në njërin rast vendos përfundimisht KPK ndërsa në rastin tjetër Komisioni për Rishqyrtim paraqet një sistem të çoroditur, i cili sistem nuk është i përcaktuar në asnjë rast tjetër. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ, ndaj të cilit edhe lejohet fillimi i konfliktit administrativ. Në rastet kur Komisioni për Rishqyrtim konstaton se kundërshtimi nuk është i bazuar, kemi të bëjmë me vendim të shkallës së dytë, ndërsa në rastet kur ky Komision konstaton se kundërshtimi është i bazuar, kemi të bëjmë me vendim të shkallës së tretë (pasi përfundimisht për të njëjtin duhet të vendosë KPK), e cila shkallë nuk njihet në procedurë administrative. LIGJI Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative në nenin 13 përcakton se “1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në **shkallë të dytë**. 2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të **shkallës së parë**, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar”. Pra, ky ligj nuk e njeh fare shkallën e tretë, të përcaktuar në këtë rregullore. Në këtë drejtim, KPK me anë të këtij sanksionimi në këtë rregullore vetëm sa do të krijojë për shtjellime në rastet eventuale të kandidatëve që do të fillojnë konflikt

administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative.

Në anën tjetër, ky përcaktim vetëm sa rrit mos standardizimin e procedurës, dhe në një proces të rëndësishëm si zgjedhja dhe propozimi i Kryeprokurorëve krijon pasiguri juridike në raport me kandidatët.

Në anën tjetër, në paragrafin 3 të nenit 12 të rregullores përcaktohet se “Komisioni për Rishqyrtim për procesin e caktuar për Kryeprokuror apo Kryeprokuror të Shtetit përbëhet nga tre (3) anëtarë të KPK.” KPK në këtë rast duhet të përcaktojë edhe atë se cili nga këta 3 anëtarë është edhe kryesues i këtij komisioni.

### **11. Procesi i votimit (Neni 17)**

Më 25 prill 2019, KPK ka anuluar konkursin për Kryeprokurorë të PSRK-së, me arsyetimin se rregullorja e KPK-së nuk është në harmoni me aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Kjo për arsye se rregullorja aktuale përcakton se kandidatët e propozuar nga komisioni duhet të votohen një për një, dhe jo në një listë të përbashkët. Për të mos e ndryshuar rregulloren në mes të procesit për kryeprokuror të PSRK-së, KPK ka anuluar tërësisht këtë proces si dhe ka autorizuar Komisionin për Çështje Normative për të hartuar rregulloren të cilës i drejtohen këto komente. Po ashtu, për të pritur miratimin e kësaj rregulloreje, KPK ka shtyrë edhe shpalljen e konkursin për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të ri të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Por, procesi i votimit i sanksionuar në këtë rregullore është procedurë e cila më së paku është në harmoni me aktgjykimet në fjalë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Sipas rregullores, KPK ka në dispozicion të vendosë vetëm për kandidatin i cili në procesin e poentimit është vlerësuar me më së shumti pikë nga paneli vlerësues. Nëse ky kandidat nuk merr votat e nevojshme, atëherë i tërë procesi përsëritet.

Në situatën e dytë, KPK ka mundësi zgjedhje në mes kandidatëve vetëm në rastin kur kemi dy apo më tepër kandidatë të cilët në procesin e poentimit nga paneli vlerësuar kanë marrë pikë të barabarta. Edhe në këtë rast, nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën e nevojshme, KPK vendos ta rishpall konkursin.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në aktgjykimin nr.KI55/15 ka përcaktuar se çështja e meritokracisë përcaktohet në komisionet paraprake të vlerësimit dhe jo në takimin e KGJK-së. Në rastin konkret, sipas Gjykatës Kushtetuese, të gjithë kandidatët kishin pasur meritat e mjaftueshme për këtë pozitë, dhe në mesin e tyre, me votim të përgjithshëm KGJK do të zgjidhte njërin nga kandidatët mes tyre. Të gjeturat e Gjykatës Kushtetuese në këtë rast janë të obligueshme edhe për KPK-në.

“Në procesin e përzgjedhjes siç është zbatuar nga KGJK-ja, secili nga kandidatët për emërim për Kryetar të Gjykatës së Apelit është vlerësuar sipas kritereve të bazuara në meritë për të



përcaktuar përshtatshmërinë e tyre për këtë pozitë. Bazuar në informatat e dhëna në Gjykatë duket se kandidatët ishin vlerësuar të kenë merita të mjaftueshme për këtë pozitë, duke qenë se secili nga kandidatët ka arritur një rezultat prej se paku 77 pikëve. Gjykata vëren se KGJK-ja konsideroi se secili nga kandidatët ka pasur merita të mjaftueshme për t'u kualifikuar për këtë pozitë, megjithëse as parashtruesja e kërkesës, dhe as KGJK-ja nuk kanë treguar domethënien e saktë të këtyre rezultateve, duke pasur parasysh se, në parim, të gjithë kandidatët u pranuan në procesin e votimit. Procesi i votimit kishte për qëllim të zgjidhte një kandidat nga kandidatët e kualifikuar mjaftueshëm. Si e tillë, çështja themelore në lidhje me meritat e secilit kandidat për t'u kualifikuar për pozitën e Kryetarit të Gjykatës së Apelit nuk është një çështje që është dashur të adresohet me votim, pasi kjo tashmë ishte adresuar në procesin e vlerësimit paraprak. . Gjykata rikujton se në procesin e votimit, aspekt themelor i parimit të "barazisë" është që çdo kandidat do të përfitojë nga "barazia e mundësive". Kjo do të thotë që të gjithë kandidatët do të kenë mundësinë të shqyrtohen në mënyre të drejtë dhe të barabartë" thuhet në paragrafët 76-78 të aktgjykimit në fjalë.

Nëse kjo rregullore miratohet si e tillë, atëherë KPK do të jetë institucioni i cili thjesht do të vendosë nëse do të noterizojë apo jo vendimin e panelit vlerësues, i cili në asnjë rrethanë nuk duhet të ketë karakter vendimmarrës.

Sipas Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 7, paragrafi 1.4, KPK vendos për emërimin e kryeprokurorëve të Prokurorisë Themelore, Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë së Apelit, në pajtim me Ligjin për Prokurorinë e Shtetit dhe Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Në këtë ligj, nuk përcaktohet askund se KPK mund të transferojë detyrat dhe përgjegjësitë në një organ tjetër, në rastin konkret tek Panelit Vlerësues.

Me anë të kësaj rregulloreje, KPK vendoset në një pozitë nënshtruese e përballë panelit vlerësues, i cili merr primatin absolut gjatë këtij procesi. Për më tepër, nga mënyra si janë formuluar dispozitat në këtë rregullore, nuk është paraparë mundësia që KPK të hedhë dyshim mbi vlerësimin e panelit vlerësues, aq më tepër në rastin kur as Komisioni për Rishqyrtim nuk gjenë se kundërshtimi i një kandidati është i pabazuar.

Po ashtu, përderisa Paneli Vlerësues ka 5 anëtarë dhe Komisioni për Rishqyrtim ka 3 anëtarë (në total 8), krijohet mundësia që disa prej anëtarëve të KPK-së të mbesin anëtar "kukulla", ku kontributi dhe vendimmarrja e tyre do të jetë e barasvlershme me zero. Kjo për arsye se aktualisht në KPK janë 10 anëtarë, dhe Paneli Vlerësues dhe Komisioni për Rishqyrtim do të plotësohen me 8 tyre. 2 anëtarët e mbetur do të mbesin pa asnjë rol, ku do të jenë në pozitën e "merr ose leje" përballë propozimit të Panelit Vlerësues.

Për të gjitha këto arsye, IKD i rekomandon KPK-së që ta rishqyrtojë këtë dispozitë, në kuptim që e njëjta të harmonizohet sipas aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese përkitazi me proceset e zhvilluara nga KGJK për emërimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit, për të cilën arsye edhe ishte anuluar konkursi për Kryeprokuror në PSRK dhe ishte shtyrë procesi për Kryeprokurorë në Prokurorinë Themelore të Prishtinës.

Me anë të një sanksionimi të tillë si në këtë rregullore, KPK do të cenojë rëndë sigurinë juridike të të gjithë kandidatëve në njërin anë, dhe në anën tjetër do të rrezikojë që vendimet e saj të rrëzohen lehtë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Në rastin e dytë, KPK do të përballet përsëri me një krizë lidhur me këto procese si dhe përsëri do të krijohet nevoja për një rregullore të re, e cila situatë do të shkatërronte sigurinë juridike nga vetë institucioni menaxhues me sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës.

## **12. Përfundimi i mandatit (Neni 20) dhe Procedura për përfundimin e parakohshëm të mandatit (Neni 21)**

### **Koment:**

*Neni 4 Neni 13 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:*

*Neni 13 Kryeprokurori*

- 1. Kryeprokurori udhëheq me punën dhe përfaqëson prokurorinë për të cilin është emëruar.*
- 2. Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore emërohen dhe shkarkohen në pajtim me ligjin.*

Me anë të kësaj rregulloreje, KPK ka përcaktuar një sistem të kundërligjshëm dhe arbitrar për përfundimin e mandatit të kryeprokurorëve, i cili deri në thelb cenon sigurinë juridike e të gjithë kryeprokurorëve të cilët janë zgjedhur në mënyrë të ligjshme nga ana e KPK-së, dhe njëkohësisht shkel parimet kushtetuese të Republikën së Kosovës.

Sa i përket përfundimit të mandatit, dispozitat e kësaj kategorie janë të një rëndësie të veçantë, dhe të njëjtat duhet të përcaktohen vetëm me ligj, dhe jo me legjislacion sekondar i cili nuk ka asnjë bazë apo mbështetje ligjore.

Lidhur me përfundimin e mandatit, në paragrafin 2 të nenit 20 janë përcaktuar rastet kur një kryeprokurori i përfundon mandati para kohe, që në ndërlidhje me nenin 21 të kësaj rregulloreje, nënkupton shkarkimin e kryeprokurorëve.

Fillimisht, duhet cekur faktin se dispozita ligjore për përfundimin e mandatit para kohe apo për shkarkimin e kryeprokurorëve nuk gjenden në Ligjin për Prokurorin e Shtetit apo në Ligjin për KPK-në.

Për këtë arsye, kriteret dhe procedura për shkarkim duhet të jetë e njëjtë sikurse ajo për të gjithë prokurorët, e përcaktuar tanimë me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Ligjit për KPK-në.

Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës në nenin 25 përcakton arsyet dhe procedurën e shkarkimit nga detyra i prokurorëve. Prokurorët mund të shkarkohen nga funksioni, për shkak të:

1.1. është dënuar për veprë penale, me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia; dhe 1.2. mosrespektimin e rëndë të detyrave.

Prokurorët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimit mbi shkarkimin drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Ligji për KPK në mënyrë taksative përcakton se Këshilli, para dërgimit të propozimit për shkarkim të prokurorit, siguron që të jenë përfunduar të gjitha procedurat përkatëse sipas legjisllacionit në fuqi, që nënkupton zbatimin e procedurave dhe kritereve të përcaktuara në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjykatës dhe Prokurorë.

Në rastin e kësaj rregulloreje përjashtohen të gjitha procedurat ligjore dhe shkelen parimet kushtetuese. Në nenin 20, paragrafi 2 përcaktohet se “Përveç sipas paragrafit 1 të këtij neni, mandati i Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorit mund të përfundojë para kohe edhe për shkaqet në vijim:

2.1. Kur dënohet për veprë penale, me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia.

2.2. Kur dështon në përmbushjen e detyrave të përcaktuara me ligj;

2.3. Kur vlerësimi i performancës nga ana e KVPP është negativ;

2.4. Kur nuk i zbaton udhëzimet e përgjithshme dhe vendimet e Kryeprokurorit të Shtetit dhe KPK; dhe

2.5. Për shkak të keq menaxhimit”.

Ndërsa, në nenin 21 të rregullores thuhet se “1. KPK shkarkon kryeprokurorin përkatës nëse plotësohen ndonjë nga kushtet e përcaktuara në nenin 20 të kësaj Rregullore. 2. Kryeprokurori i Shtetit mund t’ia propozojë KPK shkarkimin e kryeprokurorit përkatës sipas kushteve të përcaktuara me nenin 20. Propozimi paraqitet në formë të shkruar me arsyetim përkatës. 3. Kryeprokurori, për të cilin është paraqitur propozimi për shkarkim mund të ftohet për tu deklaruar para KPK-së. 4. Vendimin për shkarkim nga pozita e merr KPK me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. 5. Dispozitat nga ky nen aplikohen mutatis mutandis edhe në rastin e propozimit për përfundim të parakohshëm të mandatit të KPSH. Në këtë rast propozimi i dërgohet Presidentit”.

Lidhur me këto dispozita, IKD konsideron se me miratimin e të njëjtave, KPK do të themelojë një sistem arbitrar, duke anashkaluar sigurinë juridike dhe procedurën lidhur me shkarkimin e prokurorëve të përcaktuar në Ligjin për KPK dhe Ligjin për PDGJP. Për më tepër, një qasje e tillë ndërton gjendje të pasigurisë ku kryeprokurorët do të jenë nën presion të vazhdueshëm nga Kryeprokurori i Shtetit dhe vetë KPK, për arsye se të njëjtit mund të shkarkohen pa asnjë procedurë. Dispozitat e nenit 20 dhe 21 të rregullores flasin qartazi se në rastin konkret nuk zhvillohet asnjë procedurë. Për më tepër, përpos faktit se Kryeprokurori i Shtetit mund të propozojë KPK-së shkarkimin e një kryeprokurori, në asnjë rast tjetër nuk përcaktohet se kush është pos Kryeprokurorit të Shtetit që mund të propozojë KPK-së shkarkimin e një kryeprokurori. Lidhur me kompetencën e kryeprokurorit për të propozuar

shkarkimin e një kryeprokurori, duhet të theksojmë se kjo kompetencë nuk gjendet askund në ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. Sa i përket Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve që e përcakton Kryeprokurorin e Shtetit si autoritet kompetent, në rastin kur përcakton se “Kryeprokurori i Shtetit për sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të Kryeprokurorëve”, KPK duhet ta ketë parasysh kuptimin e drejtë të autoritetit kompetent. Në rastin e këtij ligji, bëhet fjalë për pranim të ankesave dhe shqyrtim paraprak, ku pastaj çështja për hetim dhe vendosje dërgohet në KPK. Sipas këtij ligji, për dallim nga kjo rregullore, e gjithë kjo bëhet me anë të një procedure strikte.

Tutje, kjo rregullore nuk vë në dispozicion asnjë mjet juridik për palën e pakënaqur. Me këtë, KPK shkel vetë Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe parimet e përgjithshme të procedurës administrative.

Sipas nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”. Në anën tjetër, neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: ...2: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj”. Neni 13 i kësaj konvente përcakton se “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”. Pra, KPK me anë të kësaj rregulloreje ka cenuar dispozitat jetike të Kushtetutës, si dokument primar për funksionimin e sistemit kushtetues dhe juridik të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative në nenin 2, paragrafi 4 përcakton se “Një ligj i veçantë mund të përcaktojë dispozita specifike për aspekte të ndryshme të procedurës administrative. Dispozitat e ligjit të veçantë **duhet të jenë në përputhje me parimet** e përgjithshme të përcaktuara në këtë Ligj dhe nuk mund të zvogëlojnë nivelin e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave juridik të palëve të përcaktuara me të këtë Ligj”. Ndërsa, në nenin 13 të këtij ligji përcaktohet parimi i të drejtës në mjete juridike, ku shprehimisht thuhet se “Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik”. Pra, rregullorja e KPK-së në këtë rast shkel edhe ligjet bazike mbi të cilat funksionon vetë procedura administrative.

Nëse i referohemi Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ky ligj në nenin 15 ka përcaktuar të drejtën e ankesës së palëve ndaj vendimit të KPK-së, fushë me të cilën nuk merret fare kjo rregullore.

Për të gjitha këto arsye, IKD e sheh shume shqetësuese dispozitën e nenit 20, e veçanërisht si shumë shqetësuese e sheh dispozitën e nenit 21 të rregullores. Për këtë arsye, IKD konsideron se KPK këtë çështje duhet ta trajtojë sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Rregulloren për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, e miratuar tanimë nga KPK. KPK duhet ta ketë parasysh se me vetë faktin se Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve përmban dispozitat edhe për kryeprokurorë, kjo fushë mbulohet nga ai ligj dhe secila ndërhyrje e KPK-së në këtë ligj me anë të legjislacionit sekondar paraqet tejkalim të kompetencave të KPK-së, krijim të dualizmave ligjor dhe cenim të parimeve kushtetuese dhe juridike mbi të cilat funksionon sistemi unik juridik i Republikës së Kosovës.

Si përfundim, IKD rekomandon që KPK ta largojë tërësisht nenin 20 dhe 21 nga kjo rregullore.